



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
ADMINISTRATOR

Nr. 837 Prot.

Vlorë më, 05.03 .2025

Lënda: Përcjellje raporti i monitorimit për periudhën Janar- Dhjetor 2024.

**MINISTRISË SË ARSIMIT DHE SPORTIT
DREJTORISË SË BUXHETIT DHE MENAXHIMIT FINANCIAR**

TIRANË

Në zbatim të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ligjit nr.10296 "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin" i ndryshuar, ligjit nr.97/2023 "Për buxhetin e vitit 2024", Udhëzimit nr.9, datë 20.3.2018 "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit", i ndryshuar, si dhe Udhëzimit nr. 22, datë 17.11.2016 të Ministrit të Financave "Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit për njësitë e qeverisjes qendrore" po ju përcjellim bashkëngjitur relacionin dhe realizimin e fondeve për 12-mujorin e vitit 2024.

Duke Ju falenderuar për bashkëpunimin!

**ADMINISTRATOR
(I komanduar)
Ingrid KARALLI**





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
ADMINISTRATOR

RELACION
RAPORT MONITORIMI JANAR - DHJETOR 2024

Buxheti i Universitetit "Ismail Qemali" Vlorë për vitin 2024 është miratuar me vendim të Bordit të Administrimit nr. 8 datë 23.02.2024.

Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë operon me programet buxhetore si më poshtë:

- a) 09450 program i aktivitetit të përditshëm.
- b) 09770 program i projekteve dhe kërkimit shkencor

1. Artikujve buxhetor

- a) Artikulli 600 Shpenzime Paga
- b) Artikulli 601 Shpenzime sigurimesh
- c) Artikulli 602 Shpenzime operative
- d) Artikulli 605 Transferta me jashtë
- e) Artikulli 606 Bursa
- f) Artikulli 230 Studime projekte
- g) Artikulli 231 Investime

2. Financimet

- a) Financim nga Granti i Buxhetit të Shtetit.
- b) Financim nga të ardhurat e veta.
- c) Financim i huaj.

Në zbatim të ligjit 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë" dhe VKM nr. 75 ,datë 12.02.2018 "Për miratimin e modelit të financimit të institucioneve publike të arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor", granti për vitin buxhetor 2024 është detajuar me vendim të Bordit të Administrimit nr 1, datë 05.01.2024. Granti i mbartur nga viti 2023 për vitin 2024 është detajuar sipas shkresës së Ministrisë së Financave nr. 1738/1 prot., datë 26.02.2024 "Dërgohet granti i mbartur për vitin 2024"

Granti i vitit 2024 dhe granti i fondeve të trashëguara nga viti 2023 (kapitulli 1, 8) janë të detajuara si më poshtë:

Granti 2024	Llog.Ekonomike	Granti 2024	Te trashëguara nga viti 2023	Total nga Buxheti
Paga	600	485,921,133	23,085,270	509,006,403
Sigurime shoqërore	601	65,000,000	10,951,661	75,951,661
Shpenzime Operative	602	40,000,000	9,539,840	49,539,840
Shp.Kërkim shkencor	602	0	2,602,491	2,602,491
Bursa	606	27,730,000	16,300,255	44,030,255
Bursa degët prioritare	606		771,000	771,000
Total Granti 2024+ të trashëguara 2024		618,651,133	62,479,517	681,130,650



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
ADMINISTRATOR**

Gjatë Vitit 2024 janë celur fondet si më poshtë:

- Sipas shkresës së MAS nr. 816/2 prot., datë 23.04.2024 "Dërgohen fondet e miratuara të për shpenzimeve kapitale për vitet 2024-2026".
- Sipas shkresës së MF nr. 2123/1, date 22.02.2024 "Dergohet detajim i granti per vitin 2024".
- Sipas shkresës së MF nr 2123/1 date 22.02.2024 "Dergohet detajim i granti per vitin 2024".
- Sipas shkresës së MF nr 15769/1 prot., date 15.11.2024 "Dergohet detajim i granti per vitin 2024".
- Sipas shkresës së MF nr 17712/1 prot., date 31.12.2024 "Dergohet detajim i granti per vitin 2024".

Nr.	Të ardhura nga buxheti (Inverstime)	Llog.Ekonomike	Kap	Programi	Vlera/Lekë
1	Nderkombetarizimi-Ndertimi I një Qendre Multifunkionale në kuadër të Ndërkombëtarizimit të UV-së"	231	1	9450	5,879,000

Nr.	Të ardhura nga buxheti	Llog.Ekonomike	Kap	Programi	Vlera/Lekë
1	Studentë që mbështeten financiarisht nga fondi ekselencës	606	8	9770	2,000,00
2	Studentë që mbështeten financiarisht nga fondi ekselencës	606	8	9770	3,189,00
3	Studentë që ndjekin ciklin e parë të studimeve	600	8	9450	4,854,95
4	Studentë që mbështeten financiarisht nga fondi ekselencës	606	8	9770	2,880,00
5	Studentë që mbështeten financiarisht nga fondi ekselencës	606	8	9770	3,760,00

A. Të ardhurat e Institucionit

Për vitin 2024 janë parashikuar 4,154 studentë për të cilët janë planifikuar të realizohen të ardhurat e veta të institucionit në vlerën 121,983,456 lekë.

Të ardhurat e parashikuara për vitin 2024/lekë				
A.	Emertimi të Ardhurave	Parashikimi 2024	Realizimi Janar - Dhjetor 2024	Realizimi në %
71096	Të ardhura nga Qeratë	100,000	81,200	81.2%
71101	Të ardhura nga Tarifat e shkollimit	46,387,056	33,677,000	72.6%
71101	Të ardhura nga Master profesional	22,680,000	17,916,000	79.0%
71101	Të ardhura nga Master Shkencor	36,722,400	29,758,000	81.0%
71101	Të ardhura nga Doktoraturë	2,000,000	600,000	30.0%
71101	Të ardhura nga Libreza Diploma,vertetime etj.	2,176,000	1,912,000	87.9%
71101	Të ardhura nga Taksë regjistrimi në Universitet	3,993,000	3,560,000	89.2%
71101	Të ardhura nga Të tjera (shërbime)	2,325,000	1,316,321	56.6%
71101	Te ardhura nga trajnimet e mesueseve	600,000	445,200	74.2%
71110	Të ardhura nga SponORIZIME	5,000,000	5,516,974	110.3%
72070	Të ardhura të vitit	121,983,456	94,782,695	77.7%
	Të ardhura të trashguara			
B.	Të ardhura nga te trashguara nga viti I meparsl	172,008,458	172,008,458	
A+B	Total te ardhura te Institucionit	293,991,914	266,791,153	

Për 12 -mujorin Janar – Dhjetor 2024 janë realizuar 94,782,695 lekë të ardhura, 77.7 % e parashikimit për vitin 2024.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
ADMINISTRATOR

B. SHPENZIMET

Buxheti për vitin 2024 dhe realizimi 12-mujor, Janar – Dhjetor 2024.

Në tabelën e mëposhtme paraqiten fondet e miratuara për vitin 2024, të detajuara sipas grup-artikujve buxhetorë dhe realizimi i tyre për 12-mujorin Janar- Dhjetor 2024 .

ANEKSI Nr. 2								
Tabela 5: Raporti i Shpenzimeve Faktike të Programit sipas Artikujve ne 000 leke						ne 000 leke		
INSTITUCIONI	UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE					KODI BUXHETOR	101136	
Programi	09450					GRUPI	11	
Llogaria ekonomike	Emertimi	Fakti 12 mujor 2023	PBA 2024-2026	Granti nga MASR per 2024 dhe te ardhurat e trasheguara nga 2023	Buxheti I miratuar per vitin 2024	Fakti deri Deri ne Dhjetor 2024	Diferenca 2024	Realizim ne % ndaj planit 12- mujor 2024
		6	3	4	5	6	7=4-5	8=6/4*100
600	Paga, Kapitulli 08	461,152	582,159	509,006	512,106	484,704	24,302	95%
601	Sigurime Shoqërore, kapitulli 08	69,646	76,184	75,951	76,646	71,614	4,337	94%
602	Mallra dhe Sherbime të Tjera, kapitulli 08	9,642	0	49,539	49,539	32,244	17,295	65%
603	Subvencione,kapitulli 08						0	
604	Transferta Korente të Brendshme,kapitulli 08						0	
605	Transferta Korente të Huaja, kapitulli 08						0	
606	Trans per Buxh. Fam. & Individ, kapitulli 08	23,121	27,730	44,030	44,030	21,469	22,561	49%
Nen-Totali	Shpenzime Korrente	563,562	686,073	678,526	682,321	610,030	68,496	90%
230	Kapitale të Patrupezuara, kapitulli 08	0	0				0	
231	Kapitale të Trupezuara, kapitulli 01-04	7,422	150,000	5,879	5,879	-	0	0%
231	Tranferta kapitale, kapitulli 08	0	0		0		0	
Nen -Totali	Shpenzime Kapitale fin Brendshem	7,422	150,000	5,879	5,879	0	0	0%
230	Kapitale të Patrupezuara	0	0	0	0	0	0	0%
231	Kapitale të Trupezuara	7,624	0	0	0	0	0	0%
232	Tranferta kapitale	0	0	0	0	0	0	0%
Nen -Totali	Shpenzime Kapitale fin Huaj	7,624	0	0	0	0	0	0%
Totali	Shpenzime Kapitale fin Huaj +fin Brendshem	15,046	150,000	5,879	5,879	0	0	0%
Totali	Korrente dhe Kapitale kapitulli 08, kapitulli 01	570,984	836,073	684,405	688,200	610,030	68,496	89%
600	Paga kapitulli 06		13,000		15,700	15,235	465	
601	Sigurime Shoqërore, kapitulli 06		5,000		7,500	4,630	2,870	
602	Mallra dhe Sherbime të Tjera, kapitulli 06	47,750	83,517		50,007	35,992	14,015	72%
603	Subvencione,kapitulli 06						0	
604	Transferta Korente të Brendshme,kapitulli 06						0	
605	Transferta Korente të Huajakapitulli 06	250	1,000		600	227	373	38%
606	Trans per Buxh. Fam. & Individ kapitulli 06	1,262	1,500		500	138	362	
606	Trans per Buxh. Fam. & Individ kapitulli 01		0				0	
Nen-Totali	Shpenzime Korrente kap 6+kap 1	49,263	104,017	0	74,307	56,222	18,085	76%
230	Kapitale të Patrupezuara, kapitulli 06	247					0	
231	Kapitale të Trupezuara, kapitulli 06	22,568	5,032		176,527	13,152	163,375	7.45%
231	Kapitale të Trupezuara, kapitulli 02	29,779					0	0%
232	Tranferta kapitale	0		0	0	0	0	0
Nen -Totali	Shpenz Kapitale kapitulli 06 kapitulli 02	52,594	5,032	0	176,527	13,152	163,375	7%
Totali	Korrente dhe Kapitale kapitulli 06, kapitulli 02	101,857	109,049	0	250,834	69,374	181,460	28%
Totali	Kapitale Hogari jashte buxhetore	7,624			33,002	14,298	18,704	43%
TOTALI	Totali (korrente + kapitale + jashte buxhetore)	680,465	945,122	684,405	972,036	693,703	268,659	71%
	Kosto mesatare /student ne lekë	168,892	238,727	174,326	234,000	172,177		

Nepunesi
zbatues

	Firma
	Data

Nepunesi autorizues

	Firma
	Data

Për periudhën Janar- Gusht 2024 në total buxheti është realizuar në masën 71 %.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE ADMINISTRATOR

1. Zëri 600 (Pagat e Punonjësve) dhe 601 (Sigurimet Shoqërore dhe Shëndetësore) .

Për vitin 2024 është parashikuar fondi i pagave për të mbuluar shpenzimet e pagave dhe sigurimeve shoqërore për 326 staf akademik, ndihmës akademik dhe administrativ me kohë të plotë dhe 105 staf akademik të ftuar dhe me kohë të pjesshme.

Fondi i pagave është miratuar në buxhetin e vitit 2024 me vendimin e Bordit të Administrimit nr. 8 datë 23.02.2024 "Për miratimin e buxhetit të vitit 2024", në vlerën 604,158,064 lekë, të cilat do të mbulohen nga granti i buxhetit të shtetit dhe të ardhurat e institucionit.

Realizimi i shpenzimeve për pagat dhe sigurimet shoqërore për periudhën Janar - Dhjetor 2024 rezultojnë në shumën totale 576,182,289 lekë, nga të cilat 499,938,598 lekë shpenzime për paga, realizuar në masën 95 % të planit të vitit 2024, dhe shpenzimet për sigurime shoqërore dhe shëndetësore janë përkatësisht 76,243,691 lekë në masën 91 % të planit të vitit 2024.

2. Zëri 602 (Mallra dhe shërbime)

Për vitin 2024 nga granti i buxhetit të shtetit të vitit 2024 është miratuar shuma 40,000,000 lekë për zërin 602 (shpenzime operative mallra dhe shërbime të tjera). Granti i papërdorur nga viti 2023 dhe i trashëguar për vitin 2024 në zërin e shpenzimeve operative është 9,539,840 lekë.

Totali i planit të buxhetit të shtetit për vitin 2024 për zërin e shpenzimeve operative është për shumën 49,539,840 lekë dhe realizimi i këtij plani për periudhën Janar – Dhjetor 2024 është përkatësisht 32,243,759 lekë për shpenzime operative, ose në masën 64 % të planit të vitit 2024.

Në lidhje me shpenzimet korente (llog. 602), që përballohen nga të ardhurat e Universitetit "Ismail Qemali" Vlorë (transferta e kushtëzuar) parashikimi i vitit 2024 është përcaktuar duke marrë në konsideratë si strukturën e stafit akademik, studentëve dhe specifikat kurikulare të çdo fakulteti apo departamenti, ashtu edhe faktin e vitit paraardhës si dhe kërkesat në p/buxhetin e vitit 2024, duke i dhënë prioritet mbështetjes me furnizimet e mallrave dhe shërbimeve për procesin e mësimdhënies. Gjithashtu kanë patur mbështetjen e nevojshme financiare në këtë buxhet aktivitetet e mardhenieve me jashtë, aktivitet social kulturore, organizim konferencash, ekspedita dhe praktikat mësimore për studentet për disa programme studimi.

Nga transferata e kushtëzuar (të ardhurat e institucionit) është miratuar në buxhetin e vitit 2024 me vendimin e Bordit të Administrimit nr. 8 datë 23.02.2024 "Për miratimin e buxhetit të vitit 2024, një vlerë prej 50,007,056 lekë dhe është realizuar për periudhën Janar- Gusht 2024 në shumën 35,992,434 lekë ose në masën 72 % të planit vjetor 2024.

Për realizimin jemi mbështetur në legjislacionin në fuqi në lidhje me prokurimin publik, duke respektuar Regjistrin e Prokurimeve Publike, të miratuar dhe nga Agjencia e Prokurimit Publik dhe në zbatim të ligjit nr. 97/2023 "Për buxhetin e vitit 2024" si dhe Udhëzimit nr. 9 datë 20.03.2018 "Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit" të ndryshuar.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
ADMINISTRATOR**

2.3 Shpenzime për kerkimin shkencor Artikulli 602 , Aktiviteti 09770.

Bazuar në strategjinë pesë vjecare të kërimit shkencor për Universitetin "Ismail Qemali" Vlorë, në mbështetje të misionit dhe arritjen e synimeve të kërimit shkencor në UV-së. Në këtë zë të shpenzimeve janë llogaritur shpenzimet në mbështetje të fakulteteve në organizim konferenca shkencore, organizim aktivitete dhe ëorkshp fondi i projekteve të fituara nga AKKSHI si dhe bashkëfinancim për projektet me financim të huaj, fond në mbështetje të kërimit shkencor për stafin akademik duke rimbursuar botime shkencore, rimbursim shpenzimesh pjesëmarrje në konferenca nderkombetare etj.

Për këtë synim në buxhetin e vitit 2024 janë parashikuar 4,180,000 lekë fonde për projektet e AKKSH-it:

Universiteti "Ismail Qemali", Vlorë					
Nr.	Titulli i projektit	Agjencia Ekzekutuese	Vlera e financuar nga AKKSHI	Shpenzuar deri 31.12.2023	Trashegohen për 2024
1	Shqipëria në shkrimet e udhëtimit të periudhës paskomuniste (1990-)	Universiteti "Ismail Qemali", Vlorë	1,094,310	946,710	147,600
2	Efektet anësore të vaksinës COVID-19 në popullatën e vaksinuar të qarkut Vlorë	Universiteti "Ismail Qemali", Vlorë	1,168,507	1,047,643	120,864
3	Ngritja e database rajonal të vlerësimit të zhvillimit psikomotor dhe socio emocional të fëmijëve 0-6 vjeç.	Universiteti "Ismail Qemali", Vlorë	2,252,372	180,506	922,715
4	Projekti Zhvillimi i ekspertizës akademike, bazuar në studime ndërdisiplinore për aplikime të sistemeve eksperte....	Universiteti "Ismail Qemali", Vlorë	2,000,000	0	538,962
5	Projekti Efikasiteti i shërbimit shëndetësor virtual pas pandemisë CoVid	Universiteti "Ismail Qemali", Vlorë	1,447,313	0	275,000
4	Barrierat dhe zgjedhjet për përmirësimin e praktikave të menaxhimit të dhimbjes në spitalet Rajonale të Jugut të Shqipërisë	Universiteti "Ismail Qemali", Vlorë	200,260	179,735	20,525
5	Studimi i ndikimit të Edukimit Muzikor në fushën e Pedagogjisë së specializuar, Një qasje kërkimore dhe e aplikuar	Universiteti "Ismail Qemali", Vlorë	576,600	0	576,600
5	Totali		8,739,362	2,174,859	2,602,266

Për periudhën Janar-Dhjetor 2024 janë realizuar 1,822,288 lekë për këto shpenzime për projektin Barrierat dhe zgjedhjet për përmirësimin e praktikave të dhimbjes dhe projektin studimi i ndikimit të edukimit Muzikor në fushën e pedagogjisë së specializuar.

Nga fondet e veta të UV-së janë parashikuar 40,068,940 lekë në mbështetje të Kërimit Shkencor për stafin e UV-së.

Realizimi për periudhën Janar- Dhjetor 2024 është 19,771,890 lekë ose 49 %.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
ADMINISTRATOR

3. Zëri 605 (Transferta Korente të Huaja).

Në vlerën 600,000 lekë e planifikuar në llogarinë 605 nga transferata e kushtëzuar për vitin 2024 janë përfshirë pagesat për kuota anëtarësimi dhe pjesëmarrje të institucionit tonë në organizime, projekte dhe aktivitete me institucionet e huaja. Kuotat e antarësimit vjetor të EUCEN, ETEN, ASEC dhe anëtarësime të reja për vitin 2024. Realizimi i këtij plani për periudhën Janar – Dhjetor 2024 është 227,200 lekë ose në masën 38 % të planit vjetor 2024.

4. Zëri 606 (Trans per Buxh. Fam. & Individ).

Për vitin 2024 granti i akorduar për Bursa për UV-në për përballimin e efekteve financiare që kanë ardhur nga zbatimi akteve ligjore për kategoritë e studentëve që përfitojnë bursë financiare është 27,730,000 lekë. Granti i papërdorur nga viti 2023 dhe i trashëguar për vitin 2024 në zërin e shpenzimeve bursa është 16,300,255 lekë. Totali i planit të bursave për vitin 2024 është 44,030,255 lekë i parashikuar për 438 studentë në nevojë dhe studentë ekselentë. Artikulli 606, kapitulli 8 përfshin të gjitha ato shpenzime për të cilat institucioni nuk përfiton mallra ose shërbime. Shpërndarja e buxhetit në këtë artikull pasqyron kërkesat e institucionit tonë për bursat e studentëve të cilat planifikohen sipas kuotës së miratuar për bursat, numrit të bursave të ndërmjetme dhe numrin e bursave të studentëve të shkëlqyer, studentët më të mirë të maturës, studentët fëmijë të prindërve të renë në krye të detyrës shtetërore etj. Kriteret më analitike për shpërndarjen e buxhetit për këtë artikull të strukturës buxhetore janë mbështetur në VKM nr. 903 , datë 21.12.2016, "Për përcaktimin e kriterëve për përfitimin e bursave nga fondi i mbështetjes studentore për studentët e shkëlqyer, studentët që studiojnë në programe studimi në fushat prioritare , dhe studentët në nevojë" të ndryshuar , Vendimeve të Këshillit të Ministrave Nr. 39 datë 23.01.2019 " Për disa ndryshime në vendimin e këshillit të Ministrave Nr. 903 datë 21.12.2016 "Për përcaktimin e kriterëve për përfitimin e bursave nga fondi i mbështetjes studentore për studentët e shkëlqyer, studentët që studiojnë në programe studimi në fusha prioritare dhe studentët në nevojë" të ndryshuar,Vendimeve të Këshillit të Ministrave Nr. 784 datë 26.12.2018 " Për disa ndryshime në vendimin e këshillit të Ministrave Nr. 903 datë 21.12.2016 "Për përcaktimin e kriterëve për përfitimin e bursave nga fondi i mbështetjes studentore për studentët e shkëlqyer, studentët që studiojnë në programe studimi në fusha prioritare dhe studentët në nevojë" të ndryshuar.

Numri i studentëve që kanë përfituar bursa për vitin akademik 2023-2024 sipas vendimeve të Bordit të Administrimit deri në periudhën aktuale është 299 studentë dhe efekti financiar 22,580,000 lekë.

UV	Bursa Miratuar Sipas vendimeve të BA-se				Paguar sipas listepagesave					
	Studente ekselente		Studente ne nevojë		Studente ekselente		Studente ne nevojë		Total	
Fakulteti	Nr. Studente	Efekt.Financ	Nr. Studente	Efekt.Financ	Nr. Studente	Efekt.Financ	Nr. Studente	Efekt.Financ	Nr. Studentesh	Vlera
FE	23	2,070,000	18	1,170,000	21	1,860,000	17	1,140,000	38	3,000,000
FSHHD	19	1,710,000	40	2,500,000	17	2,950,000	33	2,070,000	50	5,020,000
FSH	35	3,150,000	99	6,850,000	23	2,070,000	98	6,660,000	121	8,730,000
FSHTN	25	2,250,000	40	2,880,000	22	1,530,000	28	2,260,000	50	3,790,000
TOTAL	102	9,180,000	197	13,400,000	83	8,410,000	176	12,130,000	259	20,540,000



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË ADMINISTRATOR

Realizimi i planit për periudhën Janar –Dhjetor 2024 për bursat e studentëve është 20,540,000 lekë ose në masën 48 % të planit vjetor 2024.

Zëri 606 transferime për buxhete familjare & individët nga të ardhurat plani për vitin 2024 është 1,500,000 lekë. Për periudhën Janar – Dhjetor 2024 janë kryer 888,591 lekë shpenzime osë në masën 59% të planit për vitin 2024.

Gjatë Vitit 2024 janë rialokuar fondet për 12 studentë që përfitojne burse nga degët prioritare.

Për periudhën Janar - Dhjetor 2024 ky fond është realizuar në 6,720,000 lekë ose 53% e plani tvjetor për vitin 2024. Fondet e parealizuara i përkasin studentëve për vitin akademik 2024-2025.

5. Zëri 231 (Kapitale të Trupëzuara).

Në buxhetin e vitit 2024 prioritet i është kushtuar investimeve për krijimin e infrastrukturës sa më të përshtatshme për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies, kërkimit shkencor, aktiviteteteve akademike, mbështetjes studentore, promovimit të institucionit tonë në rajon e më gjerë, duke krijuar kushte sa më të favorshme për këtë qëllim.

Investimet për vitin 2024 janë parashikuar në vlerën 312,232,851 lekë, bazuar në nivelin e të ardhurave si dhe duke analizuar investimet që janë kryer ndër vite në fakultete.

Planifikimi i nevojave për investime për vitin 2024 është bërë mbi bazën e nevojave të evidentuara në institucion me argumentimet përkatëse. Në detajimin i investimeve në kuadër të zhvillimeve afatmesme dhe strategjike janë marrë në konsideratë detyrimet nga buxheti i vitit të kaluar, kontratat në proces dhe prioritetet për zhvillimin e Universitetit.

Përqindjen më të lartë të kuotës së planifikuar në këtë zë e ka ndërtimi i godinës së re të Fakultetit të Shëndetit për të cilën jemi bazuar në rekomandimet e dhëna nga Bordit të Akreditimit i cili në Vendimin nr. 71, datë 21.09.2017, "Për akreditimin e parë të Institucionit të Arsimit të Lartë "Ismail Qemali" Vlorë, në rekomandimet e dhëna për këtë Institucion në pikën 2, të rekomandimeve është cilësuar: "Universiteti duhet të ndërmarrë një plan të detajuar masash për përmirësimin e infrastrukturës fizike të institucionit për të përmbushur plotësisht standartet dhe të sigurojë cilësi të njëjtë fasilitetesh dhe akomodimi në të gjithë mjediset universitare.

Nisur nga sa më sipër Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë ka vendosur më vendimmarrje të organeve kolegjiale unanimisht ngritjen e objektit të ri të "Fakultetit të Shëndetit Publik" për të cilin është lidhur kontrata nr. 15/24 prot., datë 11.06.2021 me vlerë totale 415,689 ,000 lekë.

Vlera e miratuar për vitin 2024 nga të ardhurat e institucionit është parashikuar vlera 124,706,895 lekë.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
ADMINISTRATOR

Gjithashtu në buxhetin e vitit 2024 janë planifikuar investime nga të ardhurat e UV-së si më poshtë:

1. Në zërin ngritje laboratorësh:

a. Blerje paisje laboratorike për Fakultetin e Shëndetit 8,000,000 lekë.

b. Paisje Laboratori për Fakultetin e Shencave Teknike dhe Naryrore 2,000,000 lekë.

Blerja e paisjeve laboratorike nuk u realizua brenda vitit 2024.

c. Qendra multifunkionale pranë FE-së:

Bazuar në shkresën e MAS nr. 149 datë 25.01.2023 "Për planifikimin dhe finacimin me përparësi të projekteve për kërkim shkencor dhe inovacion" do të bashkëfinancohen projektet e MAS në vlerën 1500,000 lekë për vitin 2024. Gjatë vitit 2023 UV u financua nga Mas në vlerën 5,879,000 lekë ne ngritje laboratoresh, e cila u realizua brenda vitit 2023.

Financimki	Kod Projektit	Emertimi I projektit	Buxheti 2023/Lekë	Buxheti 2024/Lekë	Total/Lekë
Buxheti	18BD426	Nderkombetarizimi-Ndertimi I nje Qendre Multifunkionale në kuadër të Nderkombetarizimit të UV-së"	5,879,000	5,879,000	11,758,000
Të ardhura			925,540	925,540	925,540
Totali			6,804,540	6,804,540	12,683,540

Vlera e mbartur per vitin 2024 u akordua nga MAS me shkresën nr. 816/ prot., datë 23.02.2024 "Dërgohen fondet e miratuara të shpenzimeve kapitale për vitet 2024-2026", e cila është realizuar 100%

Gjithashtu sipas shkresës së MAS nr. 370 prot., datë 16.01.2024 "Për parashikimin e fondeve të projekteve me financim të huaj për periudhën 2024-2026", me vendim të BA-së nr. 5 datë 25.01.2024 Universiteti ka planifikuar të bashkëfinancoj 1,500,000 lekë per projektet e reja te financuara nga Mas për vitin 2024.

2- Në zërin blerje kondicioner: Në lidhje me zërin "Blerje kondicionerë" një pjesë e ambjenteve u plotësuan gjatë vitit 2023, për vitin 2024 parashikojmë F-V për 7 kondicioner me fuqi 18 BTU dhe 9 me fuqi 12 BTU.

"Blerje kondicioner" u realizua ne vleren 1,897,400 lekë.

Rinkostruksion:

- Ndërtimi i shkallëve të emergjencës për godina A, B dhe C.

Ky shpenzim ishte parashikuar në buxhetin e vitit 2023 në vlerën 8,048,000 lekë. Projekti nuk u realizua për mungesë fondesh. Pasi nga studim projektimi i shkallëve të emergjencës sipas projektit vlera rezultoj 13,023, 565 lekë.

Bazuar në VKM-në nr. 418 datë 10.05.2017 "Për standardet, kriteret dhe procedurat për hapjen, riorganizimin, ndarjen, bashkimin ose mbylljen e institucioneve të arsimit të lartë dhe të degëve të tyre",



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
ADMINISTRATOR**

pika ç) objektet e arsimit të lartë, me më shumë se 200 studentë (në një godinë), detyrimisht duhet të jenë të pajisur me dalje dhe shkallë emergjence, parashikojmë këtë fond për vitin 2024.

Për këtë investim është lidhur kontrata me vlerë 10,730,000 lekë.

- Rikonstrukcion i Sallës së Bordit dhe Senatit, kati i parë dhe i tretë në Rektorat dhe Amfiteatri salla C100 pranë FSHTN-së:

Është realizuar në vlerën 4,030,972 lekë.

Blerje inventar ekonomik për Sallën së Bordit dhe Senatit, kati i parë dhe i tretë Rektorati dhe Amfiteatri salla C100:

Është realizuar në vlerën 4,601,369 lekë.

Studim projektim për Rikonstrukcion Holli kati i parë Rektorati salla e Senatit dhe Bordit Holli kati i 3-te klasa C100.

Për të realizuar rikonceptimin e ambjenteve të mësipërme është ineqvojshme realizimi i projektit nga një studio projektimi me experience. Për këtë qëllim kemi parashikuar një fond prej 250, 000 lekë ku është shpenzuar në vlerën 202,416 leke.

Ka përfunduar procedura brenda vitit 2024.

Ndërtimi i rampës Godina A dhe B.

Hidroizolim i taracës së katit të dytë në Rektorat.

Blerje

Blerje Paisje për PodCast: Në vlerën 3,000,000 lekë, bazuar në shkresën e Sektorit të Komunikimit dhe Mardhënieve me Publikun nr.230/2 prot., Datë 31.01.2024 është vlerësuar investimi për krijimin e një radio universitare. Sipas shkresës së sipërcituar krijimin e një radio universitare është një mundësi e shkëlqyer për të përhapur informacionin, për të lancuar dhe promovuar vlerat dhe arritjet e UV-së
Nuk u realizua gjatë vitit 2024.

Blerje e pajisjeve elektronike. Pasi u panë gjithë kërkesat e njësive për "Blerje pajisje elektronike" u diferencuan kërkesat më të domosdoshme. Për përlogaritjen dhe specifikimet teknike jemi bazuar te "Specifikimet teknike dhe cmimet e afishuara nga AKSHI për vitin 2024. Kemi planifikuar 2 fotokopje printer profesionale dhe do të blihen 10 njësi kompjuteri për paisjen e Biblotekës qendrore me kompjutera,

"Është realizuar në vlerën 2,622,000 lekë.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË
ADMINISTRATOR

6. Investimet e huaja.

Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë ka aktualisht projektet e mëposhtme me financim të huaj.

Plan Buxheti për vitin 2024, sipas shkresës së MAS nr. 937/2 prot., datë 16.03.2023 është 31,024,000 lekë, sipas tabelë së mëposhtme.

Realizimi Janar - Dhjetor 2024 është 2,297,000 Lekë ose 7 % e planit për vitin 2024.

Nga financimet e huaja janë planifikuar për vitin 2024 investime nga granti i BE (Blerje laborator,paisje kompjuterike etj) në vlerën 117,900 Eur, nga të cilat janë relizuar per periudhën Janar-Gusht 2024, 0 Lekë

Kodi projektit	Emertimi i projektit	Vlera e plotë e projektit	Viti i fillimit të projektit	Viti i përfundimit të projektit	Buxheti i kontraktuar	Plani i buxhetit viti 2024 (Kap 2)	REALIZIMI PROGRESIV nga fillimi i projektit deri në 31.12.2023	REALIZIMI për periudhën e raportimit (12-mujore/vjetore)	REALIZIMI PROGRESIV nga fillimi i projektit deri në periudhën aktuale	Komente
18BE003	Establishment of Business Clubs for the enhancement of entrepreneurship in the cb area	14,211	2018	2021	12,537	1,523	1,873	0	1,873	
18CJ920	Universiteti "I.Qemali", Vlorë_Reconnecting universities and enterprises to unleash regional innovation and entrepreneurial activity- "KNOWVILLIJS"	16,955	2019	2023	14,744	31	7,153	138	7,291	
18CJ921	Universiteti "I.Qemali", Vlorë_International Parks and Gardens Resources in Adriatic and Ionian Tourist Marketplace- "TANGRAM"	19,164	2019	2022	16,289	3,855	34,307	3,847	38,154	
18CJ922	Universiteti "I.Qemali", Vlorë_Entrepreneurial skills for a modern education in Albania-ENTRAL	10,339	2021	2024	8,991	1,000	21,653	86	21,739	
18CJ924	Universiteti "I.Qemali", Vlorë_Sustainable University - Enterprise Cooperation for Improving Graduate Employability- SUCCESS	9,991	2020	2023	8,688	749	9,221	1,141	10,362	
18CJ925	Universiteti "I.Qemali", Vlorë_Development of Regional Joint Master Program in Maritime Environmental Protection and Management- MEP&M	20,722	2021	2024	18,019	2,072	23,171	1,230	24,401	
18CJ926	Universiteti "I.Qemali", Vlorë_MSc course in STEAM education - STEAMedu	8,104	2021	2024	7,047	2,340	1,006	616	1,622	
18CJ928	Universiteti "I.Qemali", Vlorë_Economic enhancement of knowledge in the food sector strengthening the technological transfer offices in albanian universities- TFO4FOOD	11,457	2020	2021	9,963	863	11,556	532	12,088	
20AB225	INTEC		2023			3,679	0	1,654	1,654	
20AB226	CREDTEACH	4941	2022	2025	4,492	1,040	7,212	2,501	7,277	
20AB227	VITALISE					1,000	0	0	0	
20AB252	SMART	8,493	2022	2025	7,721	4,070	0	3,187	3,187	
20AB271	ILOFORDIGITAL	3,607	2024	2025	3,607	3,036	0	0	0	
20AB272	MORIN	8,131	2023	2025	7,392	5,125	0	3,606	3,606	
20AB273	HAWKING	7,133	2023	2026	6,485	4,496	0	0	0	
20AB274	WB HEI ZERO	15,610	2023	2025	14,191	9,693	0	1,964	1,964	
18CJ927	Universiteti "I.Qemali", Vlorë_Smart Energy Community for Smart City	4,416	2020	2021	3,840		5,973	757	6,730	
20AB203	Universiteti "I.Qemali", Vlorë_Projekti "Sustainable development of Blue economies through higher Education and innovation in Western Balkan Countries, BLUEWBC"	25,529	2020	2023	22,199	0	21,899	32	21,931	
18BE002	Reforming doctoral studies in Montenegro and Albania MARDS	9,977	2018	2021	8,675	0	7,212	65	7,277	
18BX501	Development and application of a system based on advanced oxidation processes for the treatment of hospital wastewaters in order to remove pharmaceutical compounds with high persistence in aquatic environment -PHAREM	21,802	2018	2021	18,959	0	4,375	0	4,375	
18BD831	Algal Forest Restoration in the Mediterranean Sea-Atimed	13,500	2019	2022	10,800		2,985	0	2,985	
18CA727	Capacity building for Blue Growth and curriculum development of marine fishery in Albania-ALMARS	9,707	2019	2022	8,411	0	7,589	0	7,589	
18CJ923	Universiteti "I.Qemali", Vlorë_Foreign Language Teaching in and for European Contexts- FoLATE	3,974	2020	2023	3,456	0	3,982	0	3,982	
Totali		148,276	22,222	20,224	130,191	33,002	72,783	14,298	84,645	

Bashkëlidhur:

Tabelat e raportimit.

Situacioni u shpenzimeve periudhen Janar-Dhjetor 2024 rakorduar me degen e Thesarit Vlorë.

Te ardhurat për periudhen Janar-Dhjetor 2024 rakorduar me degen e Thesarit Vlorë.

Konceptoi: E. Islami

ADMINISTRATOR
(I komanduar)
Ingrid KARALLI



REPUBLIKA E SHOIPERISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË
SITUACION SHPENZIMESH JANAR- DHJETOR 2024

ART	N/Art	Emertimi	(grupi, Titulli, Kategoria)					
			Fonde Buxheti			Fonde nga te ardhurat		
			Tit 09450 K1-4	Tit 09450 K-1	Tit 09450 K-6	Tit 09770 K-6	Tit 09770 K-8	Tit 09450 K-8
230		Plan						
		Fakt	0	0	202,416.00	0	0	0
	2302100		0	0	0.00	0	0	0
		Shpenzime per rritjen e AQ - studime dhe kerkime Programi	0	0	0.00	0	0	0
	2302100	Tempus U3M-AL	0	0	202,416.00	0	0	0
231		Plan	5,879,000		116,153,723.80	3,000,000		0
		Fakt	5,879,000	-	13,151,741.00	1,177,140	0	0
	2312101	Shp.ndertesa administrative	0	0	0.00	0	0	0
	2312103	Shp.Ndertesa shkollore	0	0	4,030,972.00	0	0	0
